

**Memorandumi i bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në mes të Këshillit
Kombëtar Federal të Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Kuvendit të
Kosovës**

Këshilli Kombëtar Federal i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe Kuvendi i Kosovës theksojnë si në vijim:

- Interesat e përbashkëta në rritjen e sigurisë, stabilitetit, paqes dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- Interesat e përbashkëta në konsolidimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy vendeve.
- Interesat e përbashkëta në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, formësimit të së ardhmes dhe inovacionit, si dhe në fushën e shkëmbimit të njohurive diplomatike ndërmjet dy palëve.
- Ushtrimin e përpjekjeve të përbashkëta për ta luftuar ekstremizmin, terrorizmin dhe çdo gjë që do të ndikonte në sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin e njerëzve.
- Këshillimin dhe shkëmbimin e pikëpamjeve mbi çështjet e shqetësimit të përbashkët.
- Respektimin e konventave ndërkombëtare, ku në vend të parë janë: Karta e OKB-së, e Drejta Ndërkombëtare, e Drejta Ndërkombëtare Humanitare dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara sipas procedurave kombëtare.

Prandaj, të dyja Palët kanë rënë dakord si në vijim:

Së pari: Rritja e kornizave të bashkëpunimit dhe shkëmbimi i pikëpamjeve për çështje të ndryshme me interes të përbashkët.

Së dyti: Rritja e komunikimit përmes kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe kryetarit të Këshillit Kombëtar Federal të Emirateve të Bashkuara Arabe, duke:

- Shkëmbyer vizita dhe aktivitete parlamentare ndërmjet të dyja palëve.
- Aranzhimin e vizitave zyrtare për tu takuar me zyrtarët qeveritarë të të dyja palëve.

Së treti: Kjo marrëveshje hynë në fuqi pas nënshkrimit nga kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryetari i Këshillit Kombëtar Federal të Emirateve të Bashkuara Arabe.

Së katërti: Secila palë mund ta ndërpresë / ndryshojë këtë marrëveshje pas pëlqimit të palës tjetër, me kusht që memorandumi do të shërbej në këtë drejtim së paku tre muaj përpara ndërprerjes/ ndryshimit.

**Kryetari i Këshillit Kombëtar Federal
të Emirateve të Bashkuara Arabe**

Shkëlqesia e Tij Dr. Amal Al Qubaisi

**Kryetari i
Kuvendit të Kosovës**

Shkëlqësia e Tij Kadri Veseli